

VENDIM
Nr.885, datë 21.12.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Zëvendëskyeministrit e Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 11/1 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 11/2, me këtë përmbajtje:

“11.2. Shtetasit e vendeve anëtare të INTERPOL-it, të cilët mbajnë pasaportën e INTERPOL-it, të miratuar me rezolutën nr.AG-2010-RES-02, datë 9.11.2010, mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë për nevoja pune, e konfirmuar kjo me autorizim të posaçëm të lëshuar nga autoritetet homologe të Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, pa pasur nevojë të pajisen me vizë nga autoritetet shqiptare apo të përdorin ndonjë dokument tjetër udhëtimi, si dhe të qëndrojnë deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda periudhës së përcaktuar 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e hyrjes së parë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha